



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**

*Zyra e Sekretares së Përgjithshme/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary*

Nr. 134/2025

Datë: 24/10/2025

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 31 (paragrafi 1) të Rregullores nr.17/2024 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 143 (paragrafi 6) të Kodit nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, si dhe nenin 11 (paragrafi 3) të Rregullores QRK-nr. 01/2020 për standardet e organizimit të brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Emërohet Grupi Punues për hartimin dhe finalizimin e Udhëzimit Administrativ për Ruajtjen e Rezultateve të ekzaminimit Molekular dhe Gjenetik në këtë përbërje:

- 1.1. Musa Gashi, IML/MD Kryesues;
- 1.2. Valmira Uka, DL/MD, zv. Kryesuese;
- 1.3. Alberita Hyseni, ZL/ZKM, anëtare;
- 1.4. Ditor Haliti, IML/MD, anëtar;
- 1.5. Përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë;
- 1.6. Përfaqësues nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë/MPB;
- 1.7. Fjolla Sojeva, DBF/MD, anëtare;
- 1.8. Medina Sopjani, DIEKP/MD, anëtare.

2. Pjesë e grupit punues ftohen edhe përfaqësues nga:

- 2.1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- 2.2. Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- 2.3. Policia e Kosovës.

3. Grupi punues nga pika një (1) e këtij Vendimi obligohet ti përmbahet rregullave dhe procedurave të përcaktuara me Rregulloren (QRK) - nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Kosovës dhe legjislacionit përkatës në fuqi për hartimin e legjislacionit.

4. Sipas nevojës dhe me qëllim të realizimit të obligimeve të përcaktuara me këtë vendim, Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftoj edhe përfaqësues nga institucione të tjera vendore dhe ndërkombëtare si dhe organizata të shoqërisë civile.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Anita KALANDERI  
  
Sekretare e Përgjithshme



*Vendimi iu dërgohet:*

- Anëtarëve të grupit punues;
- Kabinetit të Ushtruesit të detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit Ligjor të Ministrisë së Drejtësisë;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.